

Blerina Hasaj është Këshilltare Kabineti pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ka kryer studimet universitare në vitin 2006-2012 pranë University of New York, Tirana dhe në bashkëpunim me Suny Empire State College Degree në Master of Arts në degën Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Shkenca Politike.

Ka përfunduar studimet postuniversitare në vitin 2014-2015 pranë CIFE: Centre International de Formation Européene/ Institute of European and International Studies me seli në Francë me program Master në Studime të Avancuara Europiane – Integrimi European dhe Studime Globale në bashkëpunim me “Institut für Europäische Politik (IEP), Berlin” dhe “Istanbul Bilgi University, Istanbul”.

Përvoja e saj filloi me internship-in në vitin 2012-2013 në Drejtorinë e Integritit në sektorin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës. Eksperiencë pune në disa institucione shtetërore dhe private në vend. Zotëron titullin/çertifikimin si Oficer Politikash në Organizatat Europiane dhe Ndërkombëtare nga Bashkimi European, çertifikim në Komunikim ndërkulturor-Kompetenca ndërkulturore nga CIFE. Ka marrë pjesë dhe kontribuar në Asamblenë e 10-të Parlamentare të Mesdheut e mbajtur në Shqipëri në vitin 2016 si asistente e jashtme e Kuvendit të Shqipërisë. Pjesëmarrëse në shumë konferenca dhe trajnime të tjera brenda dhe jashtë vendit në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut.